



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS - SHITIME**  
**Nr.01-060/01-10587/20 datë:26.06.2020**



**Npi – 01/132 datë: 30.06.2020**

Në bazë nenit 44 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Nenit 37 të Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636, datë:03.09.2008; Si dhe në bazë të nenit 3.2 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/149, datë:31.05.2019, për mbledhjen e Jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës, së Shtimes e mbajtur më: 30.06.2020 është nxjerrë ky:

**E K S T R A K T**  
**P R O C E S V E R B A L**

**I M B L E D H J E S S Ë -II- T Ë J A S H T Ë Z A K O N S H M E T Ë K U V E N D I T T Ë K O M U N Ë S S Ë S H T I M E S**

E mbajtur më: 30.06.2020, e (martë) në ora 11.00h në sallën e Kuvendit Nr.1

Në mbledhje kanë marrë pjesë: znj.Medina Brahaj, z.Perparim Ramusa, z.Shefki Dauti, z.Herolind Selmani, z.Reshat Mujota, znj.Arbresha Syla, z.Milot Deliu, znj.Fatmire Ferati, z.Naim Zejna, z.Skender Hyseni, znj.Zarife Rexhaj, znj.Valentina Halili-Ferati, z.Ruzhdi Jashari, z.Besnik Seferi, znj.Marigona Pajaziti, z.Fehmi Hysenaj, znj.Adelina Beqaj, z.Isak Muslija, znj.Diarta Vishesella, z.Muhamet Ademaj, z.Rexhep Gashi.

Përveç delegatëve në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Naim Ismajli; Zyrtarja Kryesore Financiare, znj.Kimete Ukaj; Zyrtari për Informim z.Lulzim Sahiti; Përfaqësuesi i OJQ-së "YAHR" z.Bekim Krasniqi.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Kuvendit znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstatoj, Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar mbledhjen e Jashtëzakonshme të Kuvendit. Për këtë mbledhje të Jashtëzakonshme kemi propozuar këtë:

**R E N D D I T E**

1. Draft - Korniza Afatmesme Buxhetore 2021-2023. (pas diskutimit publik)

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Para se të hapë diskutimin për rendin e ditës, tha: Materialin për këtë pikë e keni marrë me kohë, arsyeja e thirrjes së kësaj mbledhje të Jashtëzakonshme është dorëzimi i KAB-it në Ministrinë e Financave deri më 30 Qershor. Hap diskutimin për rendin e ditës, edhe pse formalisht kjo mbledhje e Jashtëzakonshme shkon vetëm me një pikë të propozuar, me ftesat që i keni marrë.

**z.Rexhep Gashi;** Përshëndetje, unë e kam të pa qartë se pse duhet me thirr mbledhje të Jashtëzakonshme, kur trajtimin e KAB-it e kemi edhe me Planin e Punës së Kuvendit, dhe ka mundur të shqyrtohet edhe në mbledhje të rregullt.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Sigurisht që e dini situatën e Pandemisë KOVID19 në të cilën gjendemi, por duhet ta kemi parasysh edhe kohën prej 15 ditësh që do të na e merr procedura e diskutimit publik që duhet bërë, për këtë arsye duhet ta nxëmë hapin për ta miratuar para 30 Qershorit 2020.

**z.Naim Zejna;** Përshëndetje, unë nuk kam diçka të jashtëzakonshme, por nuk po më pëlqen vetë termi Jashtëzakonshëm, prandaj vërejtja ime është se nuk është dashur të quhet mbledhje e Jashtëzakonshme.

**z.Shefki Dauti;** Përshëndetje, unë mendoj se jemi në një situatë jo të zakonshme, pastaj kur kësaj i shtohet edhe diskutimi publik prej 15 ditësh, mendoj se ka arsye të jetë mbledhje e Jashtëzakonshme.

**z.Ruzhdi Jashari;** Përshëndetje, jam plotësisht dakord, që nëse KAB-in e kemi në Planin e Punës, atëherë duhet të shqyrtohet në mbledhje të rregullt, e jo në mbledhje të Jashtëzakonshme. Justifikimi i juaj për diskutim publik nuk është i mjaftueshëm. Unë mendoj se arsyeja e vërtetë është qëllimi që pikat tjera të rendit të ditës të abstrahohen.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Konstatoi Kuorumin prej 19 anëtarëve prezent në mbledhje.

**\* Kuvendi i Komunës, me 16 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 3 vota “Abstenim” aprovoi rendin e ditës.**

#### Pika 1

##### Draft - Korniza Afatmesme Buxhetore 2021-2023. (pas diskutimit publik)

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Kimete Ukaj.

**znj.Kimete Ukaj, Zyrtare Kryesore Financiare;** Përshëndetje, KAB-in që ne sot po e prezantojmë para jush është pra dokumenti bazë për aprovimin më vonë të Buxhetit të Komunës sonë. Baza ligjore është konsultuar dhe është përmbledhur në dokument. KAB-i tani më siç e dini miratohet për çdo vit kalendarik, mbi bazën e dokumentit bazë të KAB-it i cili vjen nga Ministria e Financave ku janë vendosë kulmi ose tavanet e shpenzimeve buxhetore mbi të cilat nuk mund të kalojmë. Ne e kemi hartuar Draft-dokumentin, duke marrë parasysh edhe diskutimet publike që i kemi organizuar sipas Vendimit të Kuvendit. Në vazhdim Zyrtarja lexoi dokumentin me shifra konkrete sipas tabelave. (shih dokumentin) Në fund delegatët i ftoi që ta votojnë KAB-in 2021-2023. Nëse ka ndonjë pyetje jam këtu për tu përgjigjur.

**z.Naim Zejna;** Përshëndetje për Kryetarin. Ne kemi marrë pjesë në diskutim publik, dhe propozimet tona janë marrë parasysh, dhe janë inkorporuar në dokument. Më vjen mirë që kemi rritje te pagat jubilarë, por shqetësues është fakti i zvogëlimit të buxhetit të arsimit. Kërkoj që të specifikohet pak më shumë gjendja te pozicioni 33, Asfaltimi i rrugës “10 Qershori” konsiderojmë se bëhet një shkarkim i madh i vizitorëve te Kompleksi. Të specifikohen pozicionet; Te numri 10 rruga “Jetë Hasani” pastaj te numri 16 në Lagjen e Pajtimit, si dhe në shtime te numri 26. mendoj se duhet me gjet zgjidhje për një Trafo për rrugën “Ahmet Shtimja” rreth e përçark, si dhe rregullimin e Kroit.

**z.Fehmi Hysenaj;** Përshëndetje, një vërejtje që po na përcjell lidhur dështimet me diskutimin publik, nuk është publikuar në F.B. e Komunës, orari i diskutimit publik. Këtu do të duhej të tregohej se cilat vërejtje nuk janë aprovuar. Nuk ka pas kujdes të shtuar në formën e dokumentit, ku janë bërë lëshime të shumta. Nëse i shohim projeksionet dhe i krahasojmë e shohim që askund nuk ja kemi qëlluar, sepse kemi mospërputhje të mëdha. Në shumicën e projekteve nuk ka kode, nuk e di pse? Pas numrit 45 normalisht duhet të jetë numri 46 e që nuk është dhe që ka të bëjë me shtratin e Lumit. Janë futur edhe disa projekte që për mua janë të përfunduara. Dua ta di se ku është vendosur që të vendoset figura e “Adem Jasharit”. Në këtë kohë Pandemie dy gjëra janë të mira, ecja nëpër trotuare dhe biciklizmi, mirëpo ne nuk po mundemi me arritur infrastrukturën bazike. 75.000€ të ndara për rrugën Petrovë – Devetak, unë mendoj se do të ishte më mirë që të shkojnë te Pishat dhe Trotuari në fshatin Muzeqinë.

**z.Muhamet Ademaj;** Përshëndetje, e falënderoj ZKF-në për KAB-in i cili është një udhëzues për hartimin e Buxhetit. Kemi informatë se Kryetari ka mbajtur takim me partitë politike, klubin e biznesit dhe sportive, unë po besoj se Kryetari i ka marrë parasysh kërkesat. Ka shumë pak projekte të parapara në fshatin Petrovë, ku dihet se është fshati më i madh. KRM “Pastërtia” nuk ofron shërbime të mira dhe nuk po shoh që ka të paraparë ndonjë investim. 75.000€ janë paraparë për rrugën Petrovë-Llanisht-Jezerc, unë mendoj se më mirë do të ishte që të ndahen për ndonjë fabrikë të ujit ose për ndërtimin e ndonjë liqeni artificial të ujit. Kjo ndarje që është bërë nuk përputhet aspak me kërkesat e qytetarëve.

**z.Shefki Dauti;** Është mjaft e vështirë që me ja qëlluar për të gjitha nevojat e qytetarëve. Do të ishte mirë që ZKF-ja propozimet ti kishte më herët, me qëllim që të inkorporohen, prandaj kërkoj që drafti

të bëhet më herët. Ne duhet ti kemi të renditura prioritetet, e që unë mendoj se janë uji dhe kanalizimi. Unë jam që KAB-i të kalojë.

**z.Ruzhdi Jashari;** Sfiduese te Komuna është se edhe sot disa projekte në KAB, nuk janë të kodifikuara. Kemi edhe një shumë mjaft të madhe Kontingjente të cilat nuk janë pasqyruar. Kam një pyetje direkt, ku e kanë vendin tani ato mjete? A ka zyrtarë të Komunës të paditur në Gjykatë, për shkak të punës së keqe, e që e ka sjellë Komunën në humbje? Ne si Vetëvendosje e kemi ngritë kaherë çështjen e Urës dhe rrugës në Reqak. Projektet e terreneve sportive duhet me u specifikuar, nëse janë kryer ose jo. Te projekti me numër 45 rregullimi i shtratit të Lumit i pa kodifikuar, shumat e mjeteve të ndara sivjet si dhe në vitin e ardhshëm arrijnë shumën prej 600.000€- Te projekti me numër 23 ura “Veseli” dhe në Rashincë, që janë specifikuar, pastaj kemi një përsëritje te numri 45 ku thuhet prapë “Rregullimi i urave”. Te projekti numër 53 ku kemi të bëjmë me përfundimin e projektit në shkollën fillore në Carralevë, e cila ende nuk ka përfunduar për shkak se nuk është kompletuar, projekti kur epet për ndërtim ai epet për me u kompletuar e jo gjysmak. Kemi pa atje mbi 40.000€ mjete shtesë. Përveç figurave të “Adem Jasharit” dhe “Ahmet Shtimes” në Rancë nuk është paraparë investim asnjë metelik. Ne nuk e përkrahim ndërtimin e shtegut Shtime–Llanisht. Ka mjete të duplikuara, por edhe nuk ka fare transparencë, qoftë në planifikimin ose realizimin e projekteve.

**z.Rexhep Gashi;** Jemi duke biseduar për një dokument të rëndësishëm. Shqetësimi im është specifikimi i projekteve. Për ndërtimin e ndonjë projekti në fshat thuhet në brendësinë e fshatrave. Pastaj kemi raste kur asfalti është shtruar vetëm për një shtëpi të vetme. E kemi një Vendim të Kuvendit për Shpellën e Pjetërshticës ku kemi thënë për investimin në asfaltimin e rrugës deri te Shpella, e që nuk ka ndodhur. Ka defekte në realizimin e disa projekteve, por te disa projekte ne fare nuk kemi pas asnjë njoftim. Klubi i Bizneseve ka pasur një kërkesë, por drejtorja nuk e ka marrë fare parasysh. Bizneset në rrugën për Lipjan nuk e kanë fare infrastrukturën sikurse që e kanë bizneset në rrugën për Ferizaj. Unë edhe më herët kam kërkuar për hapjen e shtratit të lumit në fshatin Rashincë.

**z.Besnik Seferi;** Përshëndetje, ne jemi këtu vetëm koti, sepse votat për miratimin e KAB-it i keni, edhe propozimet që i japim ne janë koti. Kur flasim për projektet, këtu flitet psh. për ndriçimin në fshatin Muzeqinë, ndërkaq që unë mendoj se ne duhet ti japim prioritet absolut furnizimit me ujë të pijes si dhe rregullimin e Kanalizimit në disa fshatra ku ende nuk ka. Te Lagja e Pajtimit flitet për kanalizim, e unë dua që ta di se a po flitet konkretisht për rrugën “Çamëria” apo po flitet për rrugën “Anton Çeta”. Unë e di që ne nuk bëjmë zgjidhje me votën tonë “Kundër”, sepse ju i keni votat për ta miratuar, por një gjë duhet të dihet se kërkesat tona janë kërkesa të qytetarëve. Unë kam pyetje konkrete, se a është përfshirë asfaltimi i rrugës “Shtegu i UÇK-së” në fshatin Godanc i Epërm?

**z.Reshat Mujota;** Përshëndetje, a jemi të kënaqur me projektet e parapara me këtë KAB, jo por këto janë mundësitë. Nëse kërkojmë për fshatin tonë, është e kuptueshme që mbesin shatrat tjera. Unë jam që çdo fshat të përfaqësohet barabarsisht me projekte përveç kur ka ndonjë prioritet të caktuar, sepse këtu në Kuvend kemi disa fshatra që fare nuk janë të përfaqësuar me ndonjë delegat. Prandaj unë jam që kërkesat të kenë një prioritet dhe nëse themi se uji e kanalizimi kanë prioritet atëherë duhet ta respektojmë këtë prioritet. Unë do ta përkrahu KAB-in.

**znj.Arbresha Sylja;** Përshëndetje, e falënderoj ZKF-në për prezantimin. Duhet të ceket se gjatë kësaj kohe është diskutuar me grupet e interesit. KAB-i është diskutuar me Klubin e Biznesit, pastaj me Shoqërinë Civile. Duhet ti përmendim edhe të arriturat sepse komuna jonë po ndryshon. Tani kërkesat për asfaltimin e rrugëve nuk janë më me kilometra por me metra. Duhet që ti japim mbështetje sepse prej vitit në vit kemi rritje të buxhetit, ka ndryshime që po i vërejmë për çdo ditë, prandaj si të tillë KAB-in ne duhet ta përkrahim.

**Kryetari, z.Naim Ismajli;** Përshëndetje, faleminderit për diskutimet dhe pyetjet. Unë po jap përgjigje në modalitetin e hartimit të KAB-it, si dhe diskutimet me grupet e interesit. E kuptoj dhe është normale që të ketë pakënaqësi dhe kërkesa të vazhdueshme. Sipas Ligjit KAB-in e propozon Ekzekutivi i Komunës, por duke pas parasysh kulmet buxhetore. Duhet të ndryshojnë edhe diskutimet krahas zhvillimit të projekteve. I kuptoj edhe preferencat e delegatëve që dikush është për ujë dikush

për kanalizim e dikush për sport. Sa i përket shpërndarjes së projekteve Carraleva ka shumë më pak segmente rrugore se disa fshatra të tjera, përveç rrugës kryesore që e ka kahe të. Projektet i ndajmë edhe në perioda kohore përveç me Kode. Për disa projekte ne e dimë që nuk e kemi kapacitetin për ta rumbullakuar për një herë, kështu që kjo nuk na e ndalon që projektin ta ndajmë në vite, ose edhe për faktin se mund të kemi edhe donacione. Të gjitha projektet janë të kodifikuara, dhe këto kode janë nga Ministria e Financave, dhe kjo tani neve na tregon se një projekt nuk mundemi që ta rikodifikojmë, ndonjë projekt. Kodet pra na tregojnë nëse një projekt ka përfunduar ose jo. Por edhe Kodi na e mundëson që të fitojmë ndonjë donacion eventuale, e që gjithsesi është në të mirën e qytetarëve. Për diskutim publik janë ftuar të gjitha partitë politike, ndërsa me LDK-në ka ndodhur një ditë përpara. Sikur të kishit pas interes, unë me secilin nga ju individualisht por edhe në grup i kisha pranuar për diskutim. Rrugën për Devetak mendoj se duhet ta bëjmë dhe duhet ta kodifikojmë sepse edhe ata banorë sado që janë larg janë tanët. Kush duhet të mendoj për ata që pra ta kenë së paku rrugën kryesore, deri sa në fshatrat tjera po flasim për rrugët dytësore. Për projektet siç janë Urat e projekte të tjera po duam që ti kodifikojmë që ta lëmë derën hapur për ndonjë donacion. Mendoj se 80% është mirë e strukturuar kjo Kornizë Buxhetore. Ne duhet të komunikojmë më shumë me Kompanitë Publike për sa i përket furnizimit me ujë dhe mirëmbajtjen e kanalizimit, por nuk duhet të kemi mungesa në investimet kapitale. Nuk do ta asfaltojmë asnjë rrugë pa qenë e shpallur si rrugë publike.

**znj.Kimete Ukaj, Zyrtare Kryesore Financiare;** Shumicën e investimeve që janë bërë i përmendi Kryetari. Sa i përket çështjes së pagave mund të them se janë përfshirë. Qëllimi është arritur, është bërë një dokument gjithëpërfshirës, në të cilin janë përfshirë edhe propozimet nga diskutimi publik. Ka mundësi që është bërë ndonjë gabim teknik, dhe kjo ka ndodhur për shkak të shpejtësisë që është dashur të përgatitet Draft - Korniza Afatmesme Buxhetore 2021-2023. Projektet janë të planifikuara dhe të kodifikuara në kode të veçanta.

**znj.Shqipe Rexhaj, drejtoresh e DPUKGGJ;** Përshëndetje, te rruga “Jetë Hasani” mjetet janë të planifikuara që nga viti i kaluar. Dy shtatorët të “Adem Jasharit” dhe të “Ahmet Shtimes” kanë me u vendosur në mesin e sheshit “Ahmet Shtimja” të gjitha janë të specifikuara dhe të kodifikuara. Ju e keni mundësinë e hapur dhe mundeni me ardhur në zyre dhe me i pa projektet.

**z.Besnik Seferi;** Nuk e di a është specifikuar edhe rruga “Shtegu i UÇK-së” në Godanc të epërm, dhe kanalizimi në Lagjen e Pajtimit, a është te rruga “Çamëria” apo te “Anton Çeta”.

**znj.Shqipe Rexhaj, drejtoresh e DPUKGGJ;** Kanalizimi te Lagja e pajtimit është në pjesë, ka te rruga “Anton Çeta” por ka edhe pjesë tjera. Ndërsa sa i përket projektit të rrugës “Shtegu i UÇK-së” në Godanc të epërm, në gjatësi prej 900 metrash, nuk është specifikuar sepse ka probleme pronësore.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Konstatoi Kuorumin prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

\* **Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e dytë të Jashtëzakonshme për vitin 2020 e mbajtur më: 09.07.2020, me 18 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 3 vota “Abstenim” aprovoi Kornizën Afatmesme Buxhetore 2021-2023.**

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Mbledhjen e jashtëzakonshme e përfundoi në ora 12.24h

Procesmbajtësi:  
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e Kuvendit  
Medina Brahaj

